



REFORMA ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE

KRITERET TEKNIKE PER NDARJEN E RE

ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE

Prill 2014

Hyrie

Reforma administrativo-territoriale është identifikuar si një nga prioritetet kyç të programit qeverisës 2013-2017 dhe synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike vendore nëpërmjet rritjes së efikasitetit të tyre, por edhe të aksesit të qytetarëve në shërbimet publike vendore.

Hartimi dhe zbatimi i reformës administrativo-territoriale, bazohet dhe konceptohet mbi bazën kuadrit ligjor si më poshtë:

- Kushtetuta e Shqipërisë;
- Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore;
- Ligji 8652 dt.31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore në Shqipëri”;
- Ligji 8653dt.31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”
- VKM Nr.1012 dt.22.11.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të shtetit për Çështjet Vendore”;
- Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës REC(2004)12 “Mbi procesin e reformës së kufijve dhe/ose strukturave të autoriteve lokale dhe rajonale”.

Qasja në hartimin e kriterëve

Ministri i Shteti për Çështjet Vendore në zbatim të programit të miratuar të qeverisë ndërmorri të gjitha masat për të garantuar mbështjetjen e duhur për zbatimin e reformës administrativo-territoriale në Shqipëri. Për këtë qëllim është arritur të merret mbështetja teknike dhe financiare e organizatave si Këshilli i Evropës (CoE), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Programi i Zhvillimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP) për të sjellë ekspertët më të mirë vendas dhe të huaj për të analizuar situatën dhe për të formuluar alternativat mbi kriteret më të mira për një ndarje të re administrative dhe territoriale.

Nga tetori 2013 pranë Ministrisë të Shtetit ka funksionuar sekretariati teknik dhe grupi i ekspertëve i përbërë nga 8 ekspertë vendas dhe 3 ekspertë të huaj nga Britania e Madhe, Suedia dhe Polonia, të cilat janë financuar nga organizatat donatore si më sipër.

Po kështu një mision i posaçëm vlerësimi, i dërguar nga Këshilli i Evropës dhe me përbërjen e ekspertëve nga vende anëtare të Këshillit të Evropës, u ndërmorr në muajin nëntor 2013 i cili përgatiti një raport me rekomandime specifike për hartimin dhe zbatimin e reformës adminstrativo-territoriale.

Në këtë kontekst janë studiuar dhe analizuar kërkesat e kuadrit ligjor, modelet e ndryshme evropiane si dhe janë shqyrtuar edhe të gjitha rekomandimet dhe studimet e posaçme për Shqipërinë në këtë fushë. Kriteret teknike përbëjnë bazën objektive mbi të cilën do të hartohet ndarja e re administrativo-territoriale e Shqipërisë.

Kriteret teknike dhe baza ligjore:

Kushtetuta e Shqipërisë në nenin 108 pika 2 shprehet se ***”ndarjet administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave të përbashkët ekonomike dhe të traditës historike”.***

Ligji 8652 dt.31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore në Shqipëri”:

Neni 63 i ligjit 8652 përcakton si vijon:

*“Ndarja administrativo-territoriale në fuqi mund të riorganizohet me ose pa ndryshim kufijsh ekzistues të njësive të qeverisjes vendore, **në përputhje me interesat ekonomike e sociale, traditën, kulturën, lidhjet tradicionale dhe vlera të tjera vendore**, për realizimin në një nivel më të lartë të funksioneve në përfitim të bashkësisë vendore ose për zbatimin e politikave të zhvillimit vendor, rajonal dhe më gjerë”.*

Kriteret e përdorura në modelet e disa shteteve evropiane: Irlanda, Danimarka dhe Suedia

Irlanda:

Irlanda, vend anëtar i BE-së me një popullsi prej 4,6 milionë banorësh (Census 2011) ka ndërrmarë një reformë të qeverisjes vendore që parashikon edhe reformën administrative-territoriale. Reforma Administrative-Territoriale në Irlandë ka nisur në muajin tetor 2012 dhe hyn në fuqi pas zgjedhjeve lokale që mbahen në muajin maj 2014, duke u zbatuar në një periudhë prej 19 muajsh.

Struktura ekzistuese (që ndryshon pas zgjedhjeve të majit 2014) e qeverisjes vendore në Irlandë si më poshtë:

- | | | |
|---------------------|-----|--------------------------------------|
| - Niveli Rajonal : | 3 | Rajone me 250 këshilltarë rajonal |
| - Niveli i Rrethit: | 34 | Rrethe me 744 këshilltarë |
| - Niveli lokal: | 114 | Autoritete lokale me 883 këshilltarë |

Koncepti i reformës territoriale bazohet në rritjen e efencës së shërbimeve nëpërmjet reduktimit të kostove administrative dhe riorganizimin e shërbimeve. Kriteri i zbatuar është **suprimi i rretheve** dhe integrimi e unifikimi i autoriteve lokale (qyteteve dhe komunave) me ato të rrethit duke krijuar autoritetin e ri të integruar vendor që do quhet **Rrethi-bashkiak** (Municipal District) e cila në kufirin administrativ do të përfshijë qytetet dhe komunat ekzistuese deri në kufijtë e rretheve ekzistues me ndryshimet përkatëse.

Nga kjo reformë numri i NJQV ulet me 65% dhe me mbi 45% ulet numri i këshilltarëve. Struktura e re e qeverisjes vendore në Irlandë pas zgjedhjeve të majit 2014 do jetë si më poshtë:

- Niveli Rajonal : 3 Rajone me 62 këshilltarë rajonalne total
- Niveli i Rrethit-bashkiak: 31 Rrethe-bashkiake me 950 këshilltarë ne total

Danimarka:

Danimarka, vend anëtar i BE-së me një popullsi prej 5 milionë banorësh dhe me një gjeografi të shpërndarë dhe shumë diverse që përfshin tokën dhe ishujt. Danimarka ka ndërmarrë një reformë administrative dhe territoriale në periudhen 2005-2007 (rreth 24 muaj) duke reduktuar ndjeshëm numrin e NJQV-ve nga 250 në 98, duke eliminuar praktikisht nivelin e komunave.

Riorganizimi territorial në Danimarkë kishte për qëllim maksimalizimin e efencës së shërbimeve publike, nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve administrative dhe konsolidimit administrativ-territorial. Reforma u bazua në 2 kritere të thjeshta:

- Një qytet-një bashki (ky kriter riorganizon territorin rreth qendrave urbane (qyteteve) duke mos lejuar njësi vendore rurale që skanë një qendër urbane);
- Çdo njësi e re duhet të ketë minimumi 20,000 banorë (kriteri i popullsisë minimale

Suedia:

Suedia, vend anëtar i BE-së, me një popullsi prej 9,7 milionë banorësh, nga të cilët 85% banojnë në zonat urbane. Suedia ka kryer 2 reforma administrativo-territoriale në vitet 1950-të dhe 1970-të si pasojë e urbanizimit të shpejtë të vendit dhe industrializimit pas luftës së dytë botërore. Sfidat që udhëhoqën reformat ishin sfidat e demografisë dhe lëvizjet masive drejt zonave urbane dhe shpopullimi i zonave rurale, që sollën diferenca dhe inefiçence në shërbimet publike vendore.

Kriteret mbi të cilat u bazuan reformat territoriale në Suedi ishte konceptimi dhe riorganizimi i njësive vendore në grupime njësisish (klustera) rreth të ashtuquajturës koncepti i **“zonës natyrale”** që përfshinte zonat rurale të orgnizuara rreth qendrave komerciale/ekonomike.

Në reformën e viteve 1950-të numri i njësive vendore nga 2500 u reduktua në 1000 njësi vendore. Pas 20 viteve në 1970, Suedia vlerësoi se reforma nuk kishte arritur qëllimin e duhur të efikasitetit të shërbimeve publike dhe ekonomisë së shkallës, kështu që ndërmorri një riorganizim të dytë të territorit duke reduktuar nga 1000 njësi vendore në 290 njësi aktuale.

Reformat territoriale në Suedi e reduktuan me mbi 85% numrin e njësive vendore nga 2500 në vetëm 290.

Studimet për reformën administrativo-territoriale në Shqipëri

Reforma aktuale administrativo-territoriale në Shqipëri nuk ka filluar nga niveli “0”. Një tentativë serioze e Qeverisë shqiptare me ndihmën e Këshillit të Evropës u ndërморr në vitet 2002-2004, si vazhdim i reformës së decentralizimit që u zbatua në vitin 2000. Për shkakë politike ajo reformë nuk arriti të materializohej në një vendimarrje konkrete.

Nga ajo kohë një sërë studimesh të kryera nga organizata apo institucione ndërkombëtare dhe shqiptare janë ndërrmarë dhe kanë rekomanduar propozime konkrete të kriterëve dhe alternativave që duhen përdorur në hartimin e reformës territoriale në Shqipëri.

Më poshtë renditen shkurtimisht gjetjet dhe rekomandimet e këtyre studimeve:

1) Kontrolli i Lartë i Shtetit

Në vitin 2013, KLSH ndërmorri një studim të auditimit të performancës me temë “Ndarja territoriale administrative tokësore në Republikën e Shqipërisë”.

Mesazhi kryesor i këtij studimi është :

“Ndarja aktuale administrative – territoriale ka sjellë ngadalësim në zhvillimin vendor dhe vartësi të NJQV ndaj të ardhurave nga buxheti i shtetit. Shqipërisë i nevojitet ndarje e re administrative – territoriale duke u bazuar në kritere të qarta, me synim rritjen e efijensës dhe efektivitetit të NJQV në realizimin e objektivave, për rritjen e shërbimeve në mënyrë sa më cilësore ndaj komunitetit”.

Në këtë studim KLSH rekomandon midis të tjerave që ribashkimi i njësive të qeverisjes vendore të bëhet duke ruajtur kufirin minimum të popullsisë prej 10 000 banorësh për komunat dhe prej 15 000 banorësh për bashkitë.

Studimi i SKL-Suedi

Me porosi të Shoqatës së Komunave të Shqipërisë, një grup ekspertësh suedezë kanë kryer një studim mbi reformën territoriale në Shqipëri duke rekomanduar 5 opsione për ndarjen administrativo-territoriale në Shqipëri. Këto opsione të studimit suedez, janë vlerësuar me vëmendje nga eksperët e grupit të punës, duke i analizuar si më poshtë:

- Riorganizimi me baza vullnetare;

Në këtë opsion janë vetë NJQV-të që marrin iniciativën për tu bashkuar vullnetarisht. Konsiderohet një proces që mund të zgjasë me vite dhe jo i përshtatshëm për Shqipërinë, duke pasur në vëmendje se nga viti 2000 ka ndodhur vetëm 1 rast i bashkimit vullnetar të 2 komunave.

- Amalgamimi/bashkimi i komunave të vogla;

Në këtë opsion kriteri kryesor është bashkimi i komunave të vogla që në thelb ka konceptin e bashkimit mekanik të NJQV-ve dhe nuk konsiderohet i përshtatshëm, nga eksperët.

- Decentralizimi asimetrik i funksioneve dhe kompetencave;

Në këtë koncept rekomadohet që funksionet dhe kompetencat e decentralizuara të kryhen vetëm nga njësi që janë të afta për ti kryer ato. Në këtë opsion njësive të vogla dhe të pa afta për ti kryer këto funksione, ju merren dhe kalohen në njësitë më të mëdha. Ky opsion është kundër konceptit të decentralizimit simetrik që parashikohet në ligjin organik dhe duke ruajtur fragmentimin aktual rrit barrën për njësitë më të mëdha. Nuk konsiderohet si opsion i përshtatshëm për tu aplikuar.

- Riorganizimi mbi bazën e Qarqeve

Në këtë opsion, propozohet që riorganizimi të bëhet brenda kufijve të 12 Qarqeve aktuale, duke grupuar NJQV-të në grupe (klustera) më të mëdha prej 5-8 NJQV për çdo qark. Në përfundim numri i rekomanduar në total i NJQV-ve mund të shkojë në rreth 80 NJQV.

- Rikthimi tek riorganizimi me bazë rrethin

Në këtë opsjon koncepti është që riorganizimi i bashkive/komunave të bëhet mbi bazën e territorit administrativ me bazë ish-rrethet. Në këtë koncept numri i NJQV-ve të reja propozohet të jetë 42 NJQV të cilat korrespondojnë me territorin e 36 rrethëve por të korrigjuar me disa qendrat e reja urbane që janë fuqizuar pas ndryshimeve të viteve 1990-të. Ky opsjon është konsideruar si më i përshtatshmi për grupin e ekspertëve dhe i mundshëm për tu aplikuar.

Studimi i DLDP-së (Zvicër)

Programi për qeverisjen vendore DLDP i financuar nga qeveria zvicerane, në vitin 2013 ndërmori një studim mbi **“zonat funksionale”** në Shqipëri në 5 qarqet e Durrësit, Lezhës, Shkodrës, Dibrës dhe Kukësit.

Koncepti i zonës funksionale, në kontekstin e këtij studimi, përdoret për të përkufizuar një hapësirë ku ndërveprimet ndërmjet banorëve dhe bashkëpunimi ndërmjet enteve qeveritare janë të shpeshta dhe të dendura. ‘Zona funksionale’ i referohet nocionit që të kuptuarit e një hapësire -- e cila do niveli që mund të jetë (bashki, qark dhe kështu me radhë) -- nuk duhet të përcaktohet përgjatë vijave administrative apo historike, por në bazë të asaj se si ndodhin ndërveprime të ndryshme brenda asaj hapësire për qëllime ekonomike (puënsimi, konsumi, tregjet, të ardhurat), qëllime sociale (shëndetësia, arsimit) dhe bashkëpunimi midis institucioneve vendore.

Me qëllim që të përcaktohen zonat funksionale në pesë qarqet e interesuara, është kryer një analizë e detajuar e disa ndërveprimeve ndërmjet banorëve të nxitura nga marrëdhëniet ekonomike dhe të shërbimeve si dhe ndërveprimet institucionale ndërmjet NJQV-ve. Në përfundim të studimit, analiza tregon se në 5 qarqet e Durrësit, Lezhës, Shkodrës, Dibrës dhe Kukësit nga 133 NJQV aktuale, riorganizimi territorial bazuar në konceptin e zonave funksionale shkon në **18-24 njësi vendore të quajtura “zona funksionale”**.

METODOLOGJIA E KRITEREVE TE PROPOZUARA

Në formulimin e kriterëve për ndarjen e re administrative-territoriale, grupi i ekspertëve shqyrtoi të gjitha modelet dhe rekomandimet si më sipër dhe pas konsultimeve intensive me aktorë vendas dhe të huaj, propozoi që alternativa më e mirë është përcaktimi i **një numri të vogël dhe të qartë** kriteresh teknike të cilat i japin fleksibilitet dhe legjitimitet procesit të zbatimit të reformës duke garantuar gjithëpërfshirjen e aktorëve dhe grupeve të interesit.

Kriteret e propozuara janë objektive dhe teknike dhe përjashtojnë aplikimin e bashkimeve mekanike apo artificiale të njësive vendore, që nuk arrijnë efikasitet ekonomik dhe ekonominë e shkallës. Kriteret e propozuara përshtatin më së miri kërkesat ligjore për kriteret të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji organik 8652 si dhe modelet e përdorura në disa nga vendet evropiane dhe studimet specifike për Shqipërinë.

Alternativa e kriterëve për ndarjen administativo-territoriale të bashkive dhe komunave (niveli bazë i qeverisjes vendore).

Në këtë kontekst si alternativë kryesore e grupit të ekspertëve për kriteret e mundshme është konceptimi i njësive të reja të qeverisjes vendore si territore që konsiderohen **“zona funksionale”**.

Koncepti i “zonës funksionale” do nënkuptojë një hapësirë territoriale ku ka një ndërveprim të dendur dhe të shpeshtë mes banorëve dhe institucioneve për qëllime ekonomike, sociale, zhvillimore dhe kulturore. Pra funksionaliteti shikohet në prizmin e ndërveprimit dhe analizimit të vektorëve të ndërveprimeve ekonomike, sociale, zhvillimore dhe kulturore.

Në këtë kuptim “zona funksionale” është njësia vendore e organizuar rreth një qendre urbane që ka numrin më të lartë të popullsisë, krahasuar me qendrat e tjera brenda zonës dhe ka mundësi për ofrimin e gamës së plotë të shërbimeve publike që duhet të ofrojë një njësi vendore, duke zbatuar edhe efikasitetin e “ekonomisë së shkallës”.

Çdo njësi e re e qeverisjes vendore bazuar në konceptin e “zonës funksionale” duhet të garantojë masën kritike të domosdoshme për funksionimin e njësisë vendore duke filluar nga ekzistenca minimalisht e një qendre urbane që të ketë infrastrukturën e nevojshme social-ekonomike si psh. ekzistencën e rrjetit të shkollave, spitaleve, qendrat e kujdesit social, shërbimet e policisë, të shërbimit zjarrfikës, të shërbimeve të transportit interurban, të shërbimeve shtetërore apo private në funksion të qytetarëve dhe bizneseve, si degët e tatimeve, postave, të rrjetit bankar etj., si dhe të ekzistencës të një baze ekonomike dhe burimeve të të ardhurave të mjaftueshme vendore me një numër të caktuar biznesesh apo asetesh të tjera ekonomike që lejojnë një perspektivë adekuate zhvillimi.

Koncepti i “zonës funksionale” ka si bazë dhe nxit gjithashtu zhvillimin policentrik të njësisë të qeverisjes vendore, që presupozon se brenda NJQV-së ekzistojnë disa qendra zhvillimi përtej qendrës kryesore urbane.

Po kështu “zona funksionale” shkëputet njëherë e mirë nga koncepti aktual i ndarjes artificiale të zonave urbane dhe atyre rurale në bashki apo komuna.

Njësitë e reja vendore nën këtë koncept presupozohen si hapësira administrative të mëdha nga pikëpamja e territorit dhe popullsisë që përfshin si zona urbane ashtu dhe zona rurale duke lejuar një harmonizim të politikave zhvillimore dhe duke ulur pabarazitë e thella midis zonave urbane dhe rurale.

“Zona funksionale” lejon gjithashtu ofrimin e shërbimeve me cilësi të njëjtë për banorët e zonave urbane dhe rurale duke garantuar “ekonominë e duhur të shkallës” për ofrimin e shërbimeve publike, diçka e pamundur në realitetin e sotëm zhvillimor të vendit me parametrat aktuale të ofrimit të shërbimeve.

Analizat dhe studimet paraprake tregojnë se “zonat funksionale” përkrijnë apo dhe në shumicën e rasteve mbivendosen me territoret administrative të ish-rretheve. Të dhënat statistikore tregojnë gjithashtu se bashkitë qendër rrethi janë edhe qendrat e gravitetit

ekonomik, social dhe te shërbimeve publike në pjesën më të madhe të vendit dhe mbeten pike referimi në politikat zhvillimore dhe në arritjen e ekonomisë së shkallës.

Pra një nga modalitetet e sugjeruara është që koncepti i “zonave funksionale” ta fillojë zbatimin nga **territoret administrative të ish-rretheve**.

Nga pikëpamja e qeverisjes vendore “rrethi” si njësi administrative nuk është më e zbatueshme si nivel organizimi administrativ, por ish-rrethet identifikohen në ligjin organik të qeverisjes vendore si koncept i nëndarjes administrative të Qarkut apo edhe në shpërndarjen e shërbimeve të dekoncentruara të ministrive të ndryshme. Gjithashtu qartazi në memorien institucionale dhe të komuniteteve, “ish-rrethet” vazhdojnë të kenë edhe sot një rol referues. Rimarrja e konceptit të madhësisë territoriale të “rrethit” do të ishte alternativë shumë e mirë për shkak se bashkitë kryesore sot janë të vendosura në qendrat e ish-rretheve .

Kriteri i mësipër bën të mundur që njësi vendore e re që krijohet, të mund të ofrojë të gjithë gamën e shërbimeve publike për të gjithë qytetaret e saj, duke mbajtur parasysh atë çka synohet të arrihet me anë të kësaj reforme, konsolidimin territorial apo thënë ndryshe zmadhimin e NJQV-ve aktuale për të siguruar performancë më të mirë të funksioneve dhe cilësi në ofrimin e shërbimeve.

Kriteri tjetër i propozuar lidhet me **distancën e qendrës së NJQV-së me territorin**. Nga një anë kjo distancë nuk duhet të jetë e tillë sa të pengojë ofrimin e shërbimeve për komunitetin, por nga ana tjetër nuk mund të krijohen NJQV të reja nëse ato gjenden shumë pranë NJQV të tjera, të cilat mund të ofrojnë më mirë shërbimet për publikun dhe të sigurojnë mundësi më të mëdha zhvillimi.

Një tjetër kriter i rëndësishëm është **parimi i vazhdimësisë territoriale**. Ky parim nënkupton që territori i një njësie të qeverisjes vendore është i vazhdueshëm dhe nuk ka “ishuj” territorialë që i përkasin një njësie tjetër vendore.

Po ashtu NJQV-të në ndarjen e re do duhet të përfshinin të gjitha ato territoret kufitare që për nga afërsia janë më pranë qendrës së saj administrative sesa qendrat e NJQV të tjera, kur kjo gjë kontribuon në racionalitetin e marrjes së shërbimeve me kosto më të ulët dhe më shpejt nga qytetarët.

Kriteri i **numrit të popullsisë** rekomandohet të jetë si një kriter referues për NJQV-të e reja të propozuara. Duke marrë parasysh gjeografinë e territorit dhe shpërndarjen e popullsisë do ishte e rekomandueshme që NJQV-të e reja të kenë një numër të konsiderueshëm banorësh, që mund të nënkuptojë një popullsi mesatarisht mbi 30.000 banorë në zonat me densitet të lartë popullsie, mbi 20.000 banorë në zonat me densitet të mesëm popullsie dhe mbi 10.000 banorë në zonat me densitet të ulët popullsie.

Përcaktimi i një numri popullsie me 3 fasha të ndryshëm është racional për shkak se terreni gjeografik i Shqipërisë është shumë i ndryshëm dhe përqendrimi i popullsisë varion sipas zonave të ndryshme fushore, kodrinore apo malore.

Kriteri i rëndësishëm (dhe kërkesë ligjore) është edhe garantimi i **lidhjeve historike dhe tradicionale** të NJQV-ve të reja. Në këtë rast NJQV-të e reja do të kishin një traditë historike të mëparshme dhe të karakterizuara nga shkëmbime tradicionale mes banorëve, me qëllim sigurimin e kohezionit social.

Kriteret e mësipërme, do kishin si synim konsolidimin dhe fuqizimin e njësive të reja të qeverisjes vendore, që ato të jenë më të mëdha nga pikëpamja e popullsisë, si një nga përbërësit e rëndësishëm të formimit të çdo njësie të qeverisjes vendore dhe më të mëdha nga pikëpamja e madhësisë territoriale, që bëjnë të mundur arritjen e “ekonomisë së shkallës” dhe efijencës së shërbimeve publike nga njëra anë dhe që respekton kufijtë tradicionalë historiko-gjeografikë si dhe që lejojnë perspektivën e zhvillimit urban dhe hapësinor.

Në përjashtim nga kriteret e mësipërme dhe si kriter i veçantë përjashtues mund të shqyrtohen rastet që marrin në konsideratë praktikrat më të mira ndërkombëtare për **mbrotjen minoriteteve etnike** aty ku këto minoritete vendosin shumicën e popullsisë së NJQV-ve ekzistuese.

Alternativat e kritereve për ndarjen e qarqeve (niveli i dytë i qeverisjes vendore).

Në rastin e Qarqeve kriteret për ndarjen e re të tyre do duhej të merrnin në konsideratë rekomandimin e ekspertëve të Kongresit të Këshillit të Evropës dhe praktikrat më të mira të ndërtimit të rajoneve evropiane.

Riorganizimi i Qarqeve do ti propozohet Komisionit parlamentar, nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, pas analizimit dhe rishikimit të funksioneve aktuale të Qarqeve nga grupi i ekspertëve teknik.

Kriteret për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore

Niveli bazë: Bashkitë dhe Komunat

1. Procesi i ndarjes administrativo-territoriale do të fillojë nga "rrethet", si njësi bazë e qeverisjes vendore, sipas përcaktimit të ligjit Nr. 8653 dt.31.07.2000 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".
2. Bashkia qendër rrethi do të jetë qendra e re e njësisë bazë të qeverisjes vendore.
3. Njësi të reja bazë të qeverisjes vendore mund të krijohen brenda kufijve të rrethit, ose nga territore të dy ose më shumë rretheve, nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:
 - a. Njësia e re e krijuar është një zonë funksionale më vehte;
 - b. Distanca e territorit me qendrën e njësisë mundëson ofrimin e gamës së plotë të shërbimeve për banorët e saj;
 - c. Njësia e re e krijuar respekton parimin e vazhdimësisë territoriale;
 - d. Duhet të ketë një numër të konsiderueshëm banorësh, mbështetur edhe në karakteristikat gjeografike të zonës dhe densitetit të popullsisë: i lartë 30.000 banorë; mesatar 20.000 banorë dhe i ulët 10.000 banorë;
 - e. Ka një traditë historike dhe karakterizohet nga lidhje tradicionale mes banorëve të gjithë territoreve përbërës;
4. Për njësitë vendore me shumicën e popullsisë përbërëse nga minoritetet etnike, kriteret e mësipërme nuk aplikohen në rast se kjo çënon parimet e konventave ndërkombëtare.

Niveli i dyte: Qarqet

Ndarja administrativo-territoriale të njësive të nivelit të dytë të qeverisjes vendore

Ministri i Shtetit, bazuar në konsultimet me të gjithë grupet e interesit dhe grupin e punës, harton propozimin për ndarjen e re administrativo-territoriale të Qarqeve si nivel i dytë i qeverisjes vendore dhe ja paraqet Komisionit të posaçëm parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale.